

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.9920 DATË 19.5.2008 “PËR PROCEDURAT TATIMORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9920/2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, bazohet në nenet 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës.

Ky projektligj synon:

- reflektimin në ligjin nr.9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ndryshimeve strukturore që ka pësuar struktura e Administratës Tatimore Qendrore me urdhrin nr.33, datë 12.2.2020, të Kryeministrit, “Për miratimin e shtrukturës organizative të personelit të Administratës Tatimore Qëndrore”, si dhe rritjen e penaliteteve për disa kundërvajtje administrative tatimore, me synimin që të ndikojnë pozitivisht në uljen e evazionit tatimor;
- parandalimin e shkeljeve që përbëjnë evazion fiskal nga subjektet e biznesit të madh, uljen e informalitetit kryesisht të këtyre shkeljeve nëpërmjet forcimit të penaliteteve, të cilat pritet të ndikojnë pozitivisht në efikasitetin dhe efektivitetin e sistemit tatimor;
- hartimin e kuadrit të nevojshëm ligjor mbi procedurat që do të ndiqen nga administrata tatimore për kontrollin e tatimpaguesve me të ardhura të larta.
- rishikimin e nivelit të gjobës për mosdorëzimin në afat të deklaratës individuale vjetore të të ardhurave për individët, nxitur dhe nga fakti se kategoria e individëve të cilët janë të detyruar të dorëzojnë këtë deklaratë, është rritur dhe me hyrjen e subjekteve që janë të punësuar në më shumë se një punëdhënës;
- rishikimin e llogaritjes së gjobës për mospagimin në afat të kësteve të tatimit mbi fitimin, me qëllim që të nxisë tatimpaguesin në shlyerjen sa më parë të detyrimit;
- kufizimin e hapësirave për evazion fiskal duke siguruar një menaxhim më të mirë të parasë dhe të parasë *cash*, nëpërmjet propozimit të dispozitave ligjore mbi detyrimin për të depozituar paratë në llogarinë bankare dhe duke vendosur limitin e arkës.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj nuk është i parashikuar në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve, për vitin 2022.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTVENDIMIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Disa nga ndryshimet e propozuara në projektligj janë të bazuara në rekomandimet e FMN-së, sipas të cilave Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve duhet të ketë kompetencën për të shqyrtuar përmbushjen e ligjit për tatimin mbi të ardhurat për të gjithë individët rezidentë dhe jorezidentë në Shqipëri, të cilët janë subjekt i tatimit mbi të ardhurat personale, për të ardhurat e realizuara me burim në Republikën e Shqipërisë, sipas ligjeve tatimore.

Në këtë kuadër, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve duhet të ketë kompetencë të kontrollojë individët, për të përcaktuar nëse të ardhurat bruto dhe të tatueshme janë deklaruar në mënyrë të arsyeshme dhe nivel të konsiderueshëm dhe nëse tatimet janë përlllogaritur saktë.

Gjithashtu, ky projektligj parashikon ndryshim për sa u përket procedurave tatimore, lidhur me mundësimin e mbajtjes së një databaze të plotë të individëve që realizojnë të ardhura të tatueshme në Republikën e Shqipërisë dhe kontrollit të tyre.

Ky ndryshim kërkohet për arsye se gjatë kryerjes së kontrolleve tatimore janë konstatuar të ardhura të padeklaraura të individëve dhe administrata tatimore ka hasur vështirësi referuar bazës ligjore në fuqi për vlerësimet tatimore të këtyre individëve.

Me mbajtjen e këtij regjistri dhe dhënies të së drejtës administratës tatimore për të vepruar kryesisht kur konstatohen mosdeklarime të të ardhurave individuale, do të mundësohet mbledhja e të ardhurave edhe nga kjo kategori tatimpaguesish.

Ligji aktual i procedurave tatimore ka parashikuar penaltetet në rastin e mosdeklarimit të punonjësve dhe fshehjes së pagës. Në kushtet e situatës reale dhe faktike të mosdeklarimit të punonjësve si dhe fshehjes së pagës reale të biznesi i madh, pasojat e të cilit reflektohen në mosmbledhjen e të ardhurave

tatimore, kanë sjellë nevojën që penalitetet administrative të parashikuara në ligjin e procedurave tatimore të ndryshohen në rritje për biznesin e madh.

Nga analizat e realizuara nga administrata tatimore rezultojnë se për 3 vitet e fundit (2019, 2020, 2021), për biznesin e madh janë vendosur 1 025 gjoba për mosdeklarim të punonjësve dhe fshehja e pagës, me një vlerë prej 142 336 266 lekë.

Edhe pse në kushtet e fatkeqësive natyrore si tërmeti dhe pandemia, administrata tatimore ka qenë më e kufizuar nga kontrollet/verifikimet fizike në terren, përsëri vihet re një numër i lartë i shkeljeve që lidhen me mosdeklarimin e punonjësve dhe fshehjen e pagës. Për pasojë, propozimi mbi penalitetet për mosdeklarim të punonjësve dhe fshehje të pagës, vjen si rezultat i domosdoshmërisë për ashpërsimin e penaliteteve për këtë kategori shkeljesh dhe tatimpaguesish. Ashpërsimi i penaliteteve, synohet të ndikojë në reduktimin e këtyre shkeljeve, mbrojtjen e individëve të punësuar, si dhe pasqyrimin real në skemën e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

Aktualisht, në ligjin nr.9920, datë 19.5.2008, parashikohet gjoba për mospagimin në afat të kësteve të tatimit mbi fitimin në masën 10% të tatimit të papaguar. Duke qenë se masa e kësaj gjobe është e njëjtë pavarësisht vonesës në pagesë të këstit, pra e njëjta gjobë paguhet si për 1 ditë vonesë, ashtu dhe kur nuk e paguan fare, propozohet rishikimi i këtij dënimi dhe përcaktimi në bazë të ditëve të vonuara të pagesës së këstit të tatim-fitimit, por jo më shumë se 365 ditë, me qëllim nxitjen e tatimpaguesve për pagesën sa më parë të detyrimit.

Në ligjin aktual parashikohet se vlera e gjobës për mosdorëzimin në afat të deklaratës individuale vjetore të të ardhurave për individët, aktualisht është në masën 5 000 lekë, si për çdo tatimpagues tjetër. Propozohet që dënimi për mosdorëzimin në afat të DIVA-s nga individët të jetë në masë më të ulët dhe konkretisht propozohet vlera prej 30 000 lekë.

Sipas rekomandimeve të FMN-së, me anë të këtij projektligji synohet saktësimi i dispozitave ligjore në lidhje me përdorimin e metodave alternative të vlerësimit në rastet e veprimeve për shmangien e tatimit dhe abuzimit me parimet e ligjit tatimor.

Ndërkohë, për sa i përket propozimit të dispozitave ligjore mbi detyrimin për të depozituar paratë (kartëmonedhat dhe monedhat) në llogarinë bankare dhe limitin e arkës, fillimisht ato u propozuan në ligjin për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit, por më pas u gjykua që mos të ishin pjesë e këtij ligji, por të ishin pjesë e ligjit për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë. Ky propozim është i rëndësishëm pasi synon kufizimin e hapësirave për evazion fiskal duke siguruar një menaxhim më të mirë të parasë dhe të parasë *cash*.

Për sa i përket dispozitave ligjore që parashikojnë rritjen e gjobave për subjektet e biznesit të madh, për mallrat e pashoqëruara me dokumente tatimore, shkelja e kryer do të kallëzohet penalisht nga administrata tatimore, vetëm në rast të përsëritjes së saj.

Gjithashtu, projektligji propozon disa shtesa dhe ndryshime në termat e përdorur në ligjin e procedurave tatimore, në mënyrë që terminologjia e përdorur në këtë ligj të jetë në koherencë me terminologjinë e përdorur në ligjin për tatimin mbi të ardhurat.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është në përputhje me nenet 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE*

Projektligji nuk synon përafrimin me ndonjë *acquis* të BE-së.

VI. PËRMbledhje SHpjeguese e PËRMBAJtjes së PROJEKTAKTIT

Neni 1 parashikon disa terma të rinj dhe ndryshime në termat e përdorur në ligjin nr.9920, datë 19.5.2008, në mënyrë që të jenë në përshtatje me termat e përdorur në ligjin për tatimin mbi të ardhurat.

Neni 2 parashikon ndryshime në nenin 8 “Tatimpaguesi rezident dhe jorezident” duke e riformuluar përmbajtjen e tij dhe përshtatur me ligjin për tatimin mbi të ardhurat.

Neni 3 parashikon ndryshimin e nenit 15 “Zyrat tatimore të qeverisjes vendore” të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008.

Neni 4 i projektligjit sjell disa ndryshime në nenin 16 të ligjit të procedurave, duke e përshtatur atë me ndryshimet strukturore që ka pësuar Administrata Tatimore Qendrore me urdhrin e Kryeministrit nr.33, datë 12.2.2020, “Për miratimin e strukturës organizative të personelit të Administratës Tatimore Qendrore” dhe përkatësisht:

- Kontabiliteti dhe statistika kalojnë nga funksionet mbështetëse tek funksionet bazë dhe operacionale si dhe shtohet verifikimi në terren;

- Rimbursimi i tatimeve ndryshon shtyllë, duke kaluar nga funksionet bazë dhe operacionale tek funksionet mbështetëse;
- Verifikimi në terren shtohet tek funksionet bazë dhe operacionale;
- Proceset e biznesit shtohen te funksionet mbështetëse;
- Teknologjia e informacionit hiqet pasi nuk ekziston më si strukturë pranë DPT-së, por pranë AKSHI-t.

Neni 5 i projektligjit sjell një trajtim më të hollësishëm të mënyrës se si do të kryhet regjistrimi i individit duke patur në fokus dhe lehtësimin e procedurave të vlerësimit dhe kontabilizimit të detyrimeve të individëve që realizojnë të ardhura të tatueshme. Gjithashtu, përmbush edhe rekomandimet e FMN-së për evidentimin e të ardhurave të tatueshme të realizuara nga individët.

Neni 6 bën një saktësim të termave/emërtesave në lidhje me legjislacionin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare duke u nisur nga fakti se ligji nr.9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, nuk është më në fuqi.

Neni 7 parashikon dispozita ligjore mbi detyrimin e tatimpaguesit për të depozituar paratë (kartëmonedhat dhe monedhat) në llogarinë bankare si dhe limitin e shumës së parave *cash* në arkën e tij.

Neni 8 parashikon ndryshime në nenin 61, pika 3, e cila përcakton detyrimin e palëve të treta për të dhënë informacion në administratën tatimore, sipas udhëzimit të përcaktuar nga ministri përgjegjës për financat, për mënyrën, kohën formën në të cilën palëve të treta u kërkohet informacion.

Neni 9 parashikon ndryshimin e përmbajtjes së nenit 62, në të cilin përcaktohen dispozitat ligjore mbi personat që u kërkohet të japin informacionin e nevojshëm administratës tatimore, për zbatimin e legjislacionit tatimor në fuqi.

Neni 10 i projektligjit parashikon të drejtën e administratës tatimore për të nxjerrë vlerësim tatimor për individët në rastet kur për ta është ushtruar kontroll tatimor. Ky ndryshim bëhet për të mbushur hendekun ligjor që ekziston në rastet kur administrata tatimore konstaton raste kur individit i lindin detyrime tatimore pasi realizon të ardhura dhe nuk i paguan ato vullnetarisht. Ky ndryshim vjen në harmoni të plotë dhe me rekomandimet e FMN për kontrollin e individëve.

Neni 11 i projektligjit ka sjellë ndryshimin e nenit 71/2, të ligjit, me qëllim harmonizimin e kësaj dispozite me standardet ndërkombëtare.

Neni 12 i projektligjit është në vijim të propozimeve të bëra në kuadër të kontrollit të individëve, dhe përcakton strukturën përgjegjëse e cila urdhëron kontrollin e individëve të cilëve u lind detyrimi për deklarin e të ardhurave.

Neni 13 parashikon ndryshime në pikën 3, të nenit 83, i cili përcakton se dërgimi i raportit të kontrollit tatimor i shkon për miratim drejtorit të drejtorisë rajonale tatimore dhe një kopje e saj tatimpaguesit. Për kontrollet e kryera nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme, raporti i kontrollit miratohet nga titullari i institucionit ose i deleguari i tij.

Neni 14 parashikon ndryshim në pikën 3, të nenit 84, ku përcaktohet dispozita mbi dërgimin e raportit përfundimtar të kontrollit tatimor tatimpaguesit dhe drejtorisë së kontrollit tatimor që ka kryer kontrollin.

Neni 15 parashikon se transferimi i shumave të parave nga llogaria e tatimpaguesit, shitja/transferimi i aktiveve ose kapitaleve të shoqërisë në këtë rast kryhet vetëm në bashkëpunim me administratën tatimore.

Neni 16 parashikon ndryshim në pikën 3, të nenit 101, e cila përcakton dispozita mbi kërkesën për thirrje që lëshon administrata tatimore për kontrollet e kryera nga strukturat e kontrollit tatimor në administratën tatimore qendrore ose nga titullari i njësisë tatimore të qeverisjes vendore.

Në nenin 17 të projektligjit propozohet të hiqet pika 5 nga neni 103 pasi deklarimi i pambledhshëm i detyrimit tatimor kryhet sipas pikës 6, të këtij neni.

Në nenin 18 parashikohet që të harmonizohet neni 105 i ligjit me ndryshimet strukturore që ka pësuar Administrata Tatimore Qendrore me urdhrin e Kryeministrit nr.33, datë 12.2.2020, “Për miratimin e strukturës organizative të personelit të Administratës Tatimore Qendrore”, dhe përkatësisht:

- Me ndryshimet strukturore Drejtoria e Hetimit Tatimor është qendëruar në DPT dhe nuk ekziston më në rajone.
- Drejtoria e Hetimit Tatimor nuk ka më funksione zbatimi, por hetimi si dhe mbledhjeje dhe analizimi të informacionit tatimor.

Në nenin 19 parashikohet propozimi i nenit 105/3, që vjen si rrjedhojë e ndarjes së funksioneve të zbatimit nga Drejtoria e Hetimit Tatimor dhe krijimi i Drejtorisë së Verifikimit dhe Koordinimit në Terren e në nivel qendror dhe rajonal e cila ka si funksion parësor marrjen e masave administrative për kundërvajtjet administrative tatimore dhe zbatimin e masave shtrënguese.

Neni 20 parashikon ndryshime në nenin 112, ku përcaktohen sanksione mbi mosrespektimin e detyrimit për regjistrim apo detyrimit për përditësimin e të dhënave, përveç sanksioneve administrative të parashikuara në ligje të tjera.

Neni 21 parashikon masën e gjobës në shumën prej 3000 lekesh në nenin 113, për tatimpaguesit individë, që nuk dorëzojnë deklaratën tatimore DIVA në afatin e caktuar.

Neni 22 parashikon ndryshime të nenit 114/1, i cili përcakton dispozita mbi mospagimin në afat të kësteve të tatimit mbi fitimin korporativ dhe tatimit mbi të ardhurat personale nga biznesi dhe vetëpunësimi, sipas ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”, dhe parashikimin e gjobës në masën 10 për qind të shumës së këstit për t’u paguar plus kamatëvonesën e llogaritur për ditët e vonuara, por jo më shumë se 365 ditë.

Neni 23 parashikon saktësim termash në nenin 118, ku përcaktohen dispozitat mbi mosmbajtjen e saktë të librave, regjistrave dhe të dokumentacionit.

Neni 24 parashikon ndryshime në pikën 3, të nenit 119, e cila përcakton penalitete në rastin e mosdeklarimit të punonjësve dhe fshehjes së pagës. Në kushtet e situatës reale dhe faktike të mosdeklarimit të punonjësve si dhe fshehjes së pagës reale tek biznesi i madh, pasojat e të cilit reflektohen në mosmbledhjen e të ardhurave tatimore, kanë diktuar nevojën që penalitetet administrative të parashikuara në pikën 3, të nenit 119, të ndryshohen në rritje për biznesin e madh.

Neni 25 parashikon një rritje të penaliteteve vetëm për biznesin e madh, me qëllim minimizimin e rasteve të mbajtjes në ruajtje, përdorim ose transportim i mallrave të pashoqëruara me dokumente tatimore. Penalitetet janë të përshkallëzuara sipas përgjegjësive tatimore të tatimpaguesit dhe vlerës së mallit të gjendur pa faturë. Masa e kallëzimit penal propozohet vetëm në rast përsëritje të shkeljes.

Neni 26 parashikon ndryshime në dispozitën ligjore për tatimpaguesin, i cili, për herë të dytë brenda vitit kalendarik, kryen shkelje, për moslëshimin e faturave dhe të faturave shoqëruese, duke përcaktuar gjobën për tatimpaguesit e tatimit të mbi të ardhurat personale nga biznesi apo vetëpunësimi; gjobën, për tatimpaguesit e tatimit mbi të ardhurat personale nga biznesi apo vetëpunësimi me TVSH-në; dhe gjobën, për tatimpaguesit e tatimit mbi fitimin korporativ.

Neni 27 parashikon saktësime termash në shkronjat “a”, “b”, dhe “c”, të pikës 1, të nenit 124, ku përcaktohen shkeljet në procedurën e fiskalizimit të faturave dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit.

Neni 28 parashikon ndryshime në pikat 1 dhe 2, të nenit 127, ku përcaktohen dizpozita mbi pengimin e kontrollit ose hetimit tatimor, duke përfshirë dhe individët me pasuri të lartë.

Neni 29 parashikon hyrjen në fuqi të ligjit.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për zbatimin e këtij projektligji.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektligj është hartuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Projektligji është publikuar dhe në Regjistrin Elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike. Gjithashtu, me datë 19 tetor u zhvillua një tryezë diskutimi lidhur me paketën fiskale me përfaqësues të këshillit tatimor dhe përfaqësues të biznesit.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE I SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektligj nuk ka efekte financiare që ndikojnë në buxhet.

KËSHILLI I MINISTRAVE